



Në bazë të nenit 17, paragrafi 1 shkronja d dhe nenit 40, shkronja c të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L -040; të neneve 29 dhe 51 të Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-455, dt. 31.3.2008 dhe të nenit 51 të Ligjit për ndërtim nr. 2004/15, dt. 27.5.2004, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 29.10.2008, merr

V E N D I M
PËR MËNYRËN E LLOGARITJES DHE LARTËSINË E KOMPENSIMIT PËR
PRANIMIN TEKNIK TË OBJEKTEVE

Neni 1

Me anë të këtij Vendimi caktohen kriteret, obligimet, baza e llogaritjes dhe procedurat për pagesën e kompensimit për punën e pranimit teknik të objekteve në territorin e Komunës së Prishtinës.

Neni 2

2.1 Pranimi teknik do të kryhet në bazë të nenit 51 të Ligjit për ndërtim 2004/15 dhe neneve 3, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit administrativ, Inspektimi teknik i objekteve ndërtimore nr. rendor 65, nr. i protokollit 26/05, si dhe të Vendimit mbi caktimin e Komisionit për pranimin teknik, të lëshuar nga drejtoria përkatëse që ka lëshuar lejen e ndërtimit .

Neni 3

Në punën e Komisionit për kontrollim teknik, do të marrin pjesë personat që i plotësojnë kriteret e caktuar me Udhëzimin administrativ, ekspertë nga Kuvendi i Komunës dhe ekspertë të pavarur nga jashtë, si dhe organizatat profesionale të licencuara.

Neni 4

Kontrollimi teknik do të kryhet jashtë orarit të rregullt të punës dhe puna e Komisionit do të kompensohet në vlerë si më poshtë:

<i>Vlera investimit</i>	100,000 €	200,000 €	400,000 €	830,000 €	2,000,000 €	3,150,000 €	5,000,000 €	20,000,000 €
		110,000 €	240,000 €	460,000 €	1,000,000 €	2,300,000 €	3,600,000 €	5,800,000 €
<i>Përqindja</i>	0.80%	0.75%	0.65%	0.56%	0.46%	0.40%	0.35%	0.30%
<i>Vlera pranimit teknik</i>	800.00 €	1,500.00 €	2,600.00 €	4,648.00 €	9,200.00 €	12,600.00 €	17,500.00 €	60,000.00 €
		825.00 €	1,560.00 €	2,576.00 €	4,600.00 €	9,200.00 €	12,600.00 €	17,400.00 €

4.1 Këto vlera të kompensimit do të vlejnjë për pranim teknik të objekteve investitor i të cilave nuk është Komuna e Prishtinës, ndërsa për objektet që investitor është Komuna e Prishtinës, vlera për pagesë do të jetë e zvogëluar 30% nga vlerat e dhëna në tabelë.

4.2 Pagesa për punën e Komisionit do të paguhet në xhirollogaritë personale të anëtarëve të komisionit, me shpërndarje të vlerave për secilin anëtarë të Komisionit, si më poshtë:

Kryetari i Komisionit	0.19x totali për komision
Arkitektura	0.165 x totali për komision
Statika	0.165 x totali për komision
Elektrika	0.10 x totali për komision
Uji dhe kanalizim	0.10 x totali për komision
Ngrohja	0.10 x totali për komision
Mbrojtja nga zjarri	0.10 x totali për komision
Personi juridik	0.08 x totali për komision

Nëse numri i natarëve të Komisionit është më i vogël, atëherë do të ruhet raporti në mes të anëtarëve brenda vlerës së caktuar sipas tabelës me shpërndarje të re.

Nëse kryetari i Komisionit kryen kontrollimin e arkitekturës ose statikës, ai do të paguhet me vlerën e kryetar të Komisionit.

Neni 5

Shpenzimet për pranim teknik i bart investitori ose punëkryesi, varësisht nga marrëveshja e bërë në mes tyre.

Neni 6

Shpenzimet për pranim teknik, të cilat përsëritën për moseliminimin e vërejtjeve të dhëna nga Komisioni, i bart punëkryesi dhe vlera e tyre do të jetë 70 % e vlerës së komisionit të parë.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Infrastrukturës Lokale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 Nr. 400-1599, më 29.10.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof. dr. Isa Mustafa